



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit
P-078
Prishtinë, më 11 dhe 12 tetor 2016

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 11 DHE 12 TETOR 2016**

Seancën e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.

Kryetari i hapi punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 10 tetor 2016.

Ai procedoi me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Debat parlamentar me rastin e arrestimit të drejtorit të Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës, z. Nehat Thaçi, nga autoritetet e Serbisë

Kryetari i njoftoi deputetët se deputeti Gëzim Kelmendi, i mbështetur edhe nga 44 deputetë të tjerë të grupeve të ndryshme parlamentare, mbështetur në nenin 69.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 38 të Rregullores së Kuvendit ka parashtruar kërkesë për mbledhje të jashtëzakonshme lidhur me rastin e arrestimit të drejtorit të Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës, z. Nehat Thaçi, nga autoritetet e Serbisë.

Kryetari e ftoi parashtruesin e kërkesës për debat parlamentar që ta marrë fjalën.

Deputeti Gëzim Kelmendi tha se arrestimi i drejtorit të Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës, Nehat Thaçi, më 29 shtator 2016, në pikën kufitare Kosovë-Serbi, është bërë në

mënyrë të jashtëligjshme dhe jolegale. Ne, si Kuvend i Kosovës, jemi të bashkuar në mënyrë unanime që ta mbrojmë të drejtën, lirinë e qytetarëve dhe lëvizjen e tyre.

Bazuar në fletarrestimet e lëshuara nga Serbia janë ndaluar më herët edhe dy figura të larta të Republikës së Kosovës, konkretisht dy ish-kryeministra, ish-kryeministri Haradinaj dhe ish-kryeministri Çeku. Edhe sot e 17 vjet pasluftës po përballemi me një agresion dhe me një fushatë denigruese nga Qeveria e Serbisë ndaj qytetarëve tanë, në përgjithësi, dhe veçanërisht ndaj pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në veçanti.

Ne, si Kuvend i Kosovës duhet t'i japim një mesazh të qartë dhe të fortë Qeverisë së Serbisë se nuk do të lejojmë që askush të fyejë dhe të lëndojë dinjitetin e bijve dhe bijave tona, Ushtrisë sonë Çlirimtare dhe shtetit të Kosovës, në përgjithësi.

Kosova është shtet sovran dhe i pavarur. Kosova nuk e do dhunën. Kosova nuk e harron të kaluarën, por Kosova e do dhe duhet ta mbrojë qytetarin e saj.

Në kërkesë është propozuar që në fund të këtij debati parlamentar të dilet me një rezolutë, e përbërë nga rekomandimet e harmonizuara nga grupet parlamentare.

Kryetari, pas diskutimit të deputetit Gëzim Kelmendi, e hapi debatin parlamentar.

Lidhur me rastin e arrestimit të drejtorit të Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës, z. Nehat Thaçi, nga autoritetet e Serbisë diskutuan: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Zenun Pajaziti; në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri; në emër të Grupit Parlamentar të LV-së, Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Pal Lekaj; në emër të Grupit Parlamentar "Nisma", Zafir Berisha; në emër të Grupit Parlamentar "6+", Qerim Bajrami; në emër të Qeverisë së Kosovës, kryeministri Isa Mustafa; ministri i Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj; ministrja e Drejtësisë, Dhurata Hoxha; ministri i Punëve të Brendshme, Skender Hyseni, si dhe deputetët: Blerta Deliu-Kodra, Anton Quni, Rexhep Selimi, Bali Muharremaj, Haxhi Shala, Ganimete Musliu, Shaip Muja, Melihate Tërmmkolli, Ismajl Kurteshi, Time Kadrijaj, Luljeta Veseli-Gutaj, Armend Zemaj, Flora Brovina, Donika Kadaj-Bujupi, Teuta Haxhiu, Besa Gaxherri, Shukrije Bytyçi, Shukri Buja, Veton Berisha, Mytaher Haskukaj, Bislim Zogaj, Driton Çausi, Albin Kurti, Faton Topalli, Sali Morina, Bekim Haxhiu dhe nënkryetari Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në fund, kryetari e ftoi parashtresin e kërkesës për debat parlamentar që ta marrë fjalën.

Deputeti Gëzim Kelmendi, në emër të propozuesit, kërkoi nga grupet parlamentare që ta formojnë një grup punues për harmonizimin e tekstit të propozim-rezolutës.

Kryetari kërkoi nga grupet parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar në grupin punues.

Me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, Kuvendi formoi grupin e punës për harmonizimin e tekstit të propozim-rezolutës, të cilën duhet t'ia paraqesin Kuvendit për miratim, në këtë përbërje: Selville Halimi, Armend Zemaj, Driton Qausi, Pal Lekaj, Lah Brahimaj dhe Qerim Bajrami.

Kryetari, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, i mbylli punimet e seancës së sotme në orën 20:15 minuta, për të vazhduar të nesërmen, në orën 10:00.

Kryetari procedoi me pikën e rendit të ditës:

1. Votimi i rezolutës lidhur me rastin e arrestimit të drejtorit të Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës, z. Nehat Thaçi, nga autoritetet e Serbisë

Kryetari e ftoi deputetin Gëzim Kelmendi që ta paraqesë tekstin e harmonizuar të rezolutës për miratim.

Deputeti Gëzim Kelmendi tha se Grupi punues, të cilin e kishte formuar Kuvendi dje, punoi sot prej orës 9:00 deri në orën 10:30 dhe nuk ka arritur t'i harmonizojë qëndrimet për një tekst të përbashkët të rezolutës. Ka pasur mospajtime kryesisht në pikën që ndërlidhet me ndërprerjen, konkretisht pezullimin e bisedimeve me Serbinë.

Unë, si propozues dhe partitë opozitare Lëvizja “Vetëvendosje”, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, “Nisma” dhe deputeti i pavarur Shaip Muja, kemi qenë njëzëri që të jetë kjo pikë e rekomandimit si pikë e rezolutës, ku kërkohet ndërprerja, konkretisht pezullimi i bisedimeve deri në lirimin e Thaçit dhe deri në zhvlerësimin e të gjitha aktakuzave për ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Por, këtë propozim timin dhe të partive opozitare nuk e kanë mirëpritur partnerët e koalicionit nga dy partitë më të mëdha dhe për këtë arsye nuk kemi mundur t'i harmonizojmë qëndrimet tona.

Deputeti Gëzim Kelmendi, i mbështetur nga grupet parlamentare opozitare dhe deputeti pa grup parlamentar, z. Shaip Muja, e propozoi tekstin e Propozim-rezolutës, si në vijim:

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon lirimin e menjëhershëm të zyrtarit të lartë të Policisë së Kosovës, drejtorit rajonal për rajonin e Mitrovicës, Nehat Thaçi.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria e Kosovës pezullimin e bisedimeve me Serbinë deri në lirimin e Thaçit dhe pezullimin e të gjitha fletarresteve dhe aktakuzave të ngritura për ish-pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
3. Bashkimi Evropian, si ndërmjetësues dhe garantues i dialogut të deritashëm në mes të Kosovës dhe Serbisë, përmes mekanizmave të tij të ndërhyjë te Qeveria e Serbisë që të lirohet Thaçi.
4. EULEX-i të deklarohet për rastin Thaçi, njëherësh kërkojmë angazhim të drejtpërdrejtë si mision me kompetenca të veçanta, dhe
5. Kërkojmë nga Qeveria e Kosovës t'i ndërmarrë të gjitha veprimet në raport me Bashkimin Evropian dhe Interpolin që Policia e Kosovës të bëhet pjesë e Interpolit, njëherësh kërkojmë që fletarrestet politike nga gjykatat e Serbisë të largohen nga sistemi i tyre.

Lidhur me propozimin e Propozim-rezolutës diskutuan: Armend Zemaj, Daut Haradinaj, Sabri Hamiti, Visar Ymeri, Zenun Pajaziti, Ismet Beqiri, Driton Çausi, Haxhi Shala, Flora Brovina, Shaip Muja, Ilir Deda, Zafir Berisha, Vjosa Osmani, Albin Kurti, Fatmir Xhelili, Shukri Buja, Time Kadrijaj, Nuredin Ibishi, Ismajl Kurteshi, Fadil Demaku, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyqi, Mufera Shinik, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Deputeti Armend Zemaj, në emër të grupeve parlamentare të koalicionit qeverisës, e paraqiti tekstin e Propozim-rezolutës, si në vijim:

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon lirim të menjëhershëm të z. Nehat Thaçi, epror i Policisë së Republikës së Kosovës.

2. BE-ja, si ndërmjetësuese dhe garantuese dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, nëpërmjet mekanizmave të saj detyruet të ndërhyjë te Qeveria e Serbisë që të lirohet eprori Nehat Thaçi.

3. Çdo komunikim i Qeverisë së Republikës së Kosovës për rastin e arrestimit të z. Nehat Thaçi, deri në lirim të tij, të bëhet vetëm nëpërmjet Zyrës së znj. Federica Mogherini, Përfaqësuese e Lartë e Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë dhe zv.presidente të Komisionit Evropian.

4. Qeveria e Republikës së Kosovës t'ia bëjë me dije BE-së se veprimet e tilla të Serbisë në raport me institucionet dhe qytetarët e Kosovës po e rrezikojnë thellë përmirësimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi dhe dialogun ndërmjet dy vendeve, duke na detyruar në reciprocitet.

5. Misioni i EULEX-it të deklarohet për rastin e z. Thaçi dhe njëherësh kërkojmë angazhim të drejtpërdrejtë si mision me kompetenca të veçanta.

6. Kërkojmë nga Interpoli që Policia e Kosovës të bëhet pjesë e kësaj organizate dhe njëherësh insistojmë që fletarrestet politike të shpallura nga Serbia të largohen nga sistemi i tyre ligjor.

Kryetari fillimisht e hodhi në votim Propozim-rezolutën e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës për debat, deputeti Gëzim Kelmendi, e mbështetur edhe nga grupet parlamentare opozitare dhe deputeti pa grup parlamentar, z. Shaip Muja.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----	19
Kundër -----	38
Abstenime -----	18

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash nuk e miratoi Propozim-rezolutën e propozuar nga deputeti Gëzim Kelmendi, e mbështetur edhe nga grupet parlamentare opozitare dhe deputeti pa grup parlamentar, z. Shaip Muja.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Propozim-rezolutën e propozuar nga deputeti Armend Zemaj, e mbështetur edhe nga grupet parlamentare të koalicionit qeverisës.

Rezultati i votimit ishte si në vijim:

Për -----	51
Kundër -----	13
Abstenime -----	8

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shumicë votash, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neneve 6.1 e 40 të Rregullores së Kuvendit, në seancë të jashtëzakonshme, të mbajtur më 11 dhe 12 tetor 2016, pas debatit parlamentar lidhur me arrestimin e z. Nehat Thaçi, njëherësh epror i Policisë së Republikës së Kosovës, nga autoritetet e Serbisë, nxori këtë:

REZOLUTË

- 1) Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon lirim të menjëhershëm të z. Nehat Thaçi, epror i Policisë së Republikës së Kosovës.
- 2) BE-ja, si ndërmjetësuese dhe garantuese dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, nëpërmjet mekanizmave të saj detyruet të ndërhyjë te Qeveria e Serbisë që të lirohet eprori Nehat Thaçi.
- 3) Çdo komunikim i Qeverisë së Republikës së Kosovës për rastin e arrestimit të z. Nehat Thaçi, deri në lirim të tij, të bëhet vetëm nëpërmjet Zyrës së znj. Federica Mogherini, Përfaqësuese e Lartë e Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë dhe zv.presidente e Komisionit Evropian.
- 4) Qeveria e Republikës së Kosovës t'ia bëjë me dije BE-së se veprimet e tilla të Serbisë në raport me institucionet dhe qytetarët e Kosovës po e rrezikojnë thellë përmirësimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi dhe dialogun ndërmjet dy vendeve, duke na detyruar në reciprocitet.
- 5) Misioni i EULEX-it të deklarohet për rastin e z. Thaçi dhe njëherësh kërkojmë angazhim të drejtpërdrejtë si mision me kompetenca të veçanta.
- 6) Kërkojmë nga Interpoli që Policia e Kosovës të bëhet pjesë e kësaj organizate dhe njëherësh insistojmë që fletarrestet politike të shpallura nga Serbia të largohen nga sistemi i tyre ligjor.

Kryetari i mbylli punimet e seancës së jashtëzakonshme në orën 12:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale